



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI EKONOMIK
DEKANI**

Nr. _____ prot.

Elbasan, më 17.03.2020

**U R D H Ë R
Nr.3, datë 17.03.2020**

**“PËR
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VLERËSIMIN E MUNDËSISË SË
ZHVILLIMIT TË PROCESIT MËSIMOR ONLINE NË FAKUTETIN
EKONOMIK”**

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 42, të Statutit të Universitetit “A.Xhuvani”, miratuar me Vendim të Senatit Akademik të UE-së Nr.5 datë 30.01.2018, si dhe në zbatim të Vendimit të Rektoratit të UE-së, të datës 17.03.2020 “Për zhvillimin e procesit mësimor online në Universiteti e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, duke marrë në konsideratë situatën e pamundësisë së pjesëmarrjes fizike të studentëve dhe pedagogëve në auditorët universitarë, për shkak të masave kombëtare të izolimit social, të ndërmarra nga Qeveria nga rreziku i COVID-19,

URDHËROJ:

1. Të ngrihet grupi i punës në Fakultetin Ekonomik për vlerësimin e mundësive për zhvillimin e procesit mësimor online në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.
2. Grupi i punës të përbëhet nga:
 1. Prof.as.Dr.Shpëtim Çerri - Kryetar
 2. Prof.Dr.Ali Turhani - Antar
 3. Prof.as.Dr. Rezarta Tahiraj - Antar
 4. Prof.as.Dr. Alketa Vangjeli - Antar
 5. Prof.as.Dr. Altin Idrizi - Antar
 6. Dr. Artan Spahiu - Antar
 7. Dr. Albana Madhi - Antar
3. Grupi i punës të realizojë këto detyra:
 - a. Të analizojë platformat virtuale on line, më të mundshme, që mund të operohen në bazë departamenti apo fakulteti, duke vlerësuar kapacitetin përdorues të këtyre platformave, mundësinë e përdorimit edhe nga telefonat celularë, mundësinë e studentëve për t'i aksesuar këto platform, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI EKONOMIK
DEKANI**

- b. Të përcaktojnë lëndët e para që do të pilotojnë leksionet online, me prioritet degët e sistemit bachelor që kanë numra më të mëdha studentësh dhe kryesisht ato të vitit të tretë që janë më afër diplomimit.
 - c. Të kërkojnë mënyrat dhe format e trajnimit me të cilat mund të trajnojnë pedagogët e tjerë për përdorimin e këtyre platformave virtuale on line.
 - d. Të asistojnë pedagogët në hapjen dhe përdorimin e këtyre platformave virtuale on line.
 - e. Të raportojnë për hapjen dhe përdorimin e këtyre platformave nga pedagogët e Fakultetit Ekonomik.
4. Grupi i punës të fillojë menjëherë nga puna për të mundësuar sa më shpejt ofrimin e mësimit on line në Fakultetin Ekonomik.
5. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof.as.Dr.Imelda Sejdini